



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit
Ministarstvo za Saobraćaj Postu i Telekomunikacije
Ministry of Transport and communications

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR.2008/4, MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,
RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR VENDOSJEN E PANOVE REKLAMUESE
NË RRUGËT REGJIONALE DHE MAGJISTRALE**

Ministri,

Duke u bazuar në autoritetin e dhënë me nenin 1.3 (ç) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 të datës 19 shtator 2001 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosove dhe nenit 5, 5.1 të Ligjit mbi Rrugët nr. 2003/11, me qëllim të krijimit të kushteve të sigurisë më të madhe për pjesëmarrësit në komunikacion gjatë shfrytëzimit të infrastrukturës rrugore, nxjerr Udhëzimin Administrativ si vijon:

Neni 1

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen rregullat, kriteret dhe procedurat lidhur me vendosjen e panove reklamuese në rrugët regjionale dhe magjistrale.

Neni 2

Panot reklamuese përgjatë rrugëve duhet të vendosen në një distancë të caktuar brenda brezit rrugor ku nuk cenohet siguria në komunikacion rrugor.

Distanca në mes të panove reklamuese duhet të jetë nga një pikë në tjetrën së paku 500 metra.

Panot reklamuese nuk mund të vendosen në vendet ku pengohet mirëmbajtja e bankinës dhe kanalit.

Skaji i panos reklamës nuk mund të kalojë distancën e kufirit të bankinës nga ana e jashtme.

Neni 3

Panot reklamuese nuk mund të vendosen aty ku konstruksioni i rrugës e pengon dukshmërinë në komunikacionin rrugor.

Në Panot reklamuese nuk guxon të dominon ngjyra e kuqe, e verdhë e përhimët dhe e gjelbër.

Panot reklamuese nuk mund të jenë në ngjyrë dhe formë si shenjat e komunikacionit.

Panot reklamuese nuk lejohet të jetë e ndriçuar me reflektor dhe me ndriçim që pengon pjesëmarrësit në komunikacion.

Neni 4

Panot reklamuese nuk mund të vendosen në udhëkryqe nëpër zonat e vendbanimeve afër shkollave dhe afër kryqëzimeve të rrugës automobilistike me hekurudhë në distanca të sigurisë në bazë të shpejtësisë së kufizuar si vijon:

Në udhëkryqe 400 metra;

Në kryqëzim të rrugës automobilistike me hekurudhë 300 metra;

Në afërsi të shkollave 400 metra;

Në afërsi të vendbanimeve minimum 300 metra para tabelës së vendbanimit.

Panot reklamuese nuk lejohet të vendosen në vendet ku pengojnë dukshmërinë e shenjave të komunikacionit.

Neni 5

Korniza e panove reklamuese duhet të jenë të madhësisë, gjerësisë, gjatësisë, lartësisë në mënyrë që mos të pengoj dukshmërinë e pjesëmarrësve në komunikacion.

Panot reklamuese duhet të jenë të madhësisë prej maksimum 3x5-M lartësisë në minimum prej 1.20- metra.

Neni 6

Korniza e Panove reklamuese duhet projektuar me vizatim teknik dhe llogarinë statike adekuate.

Dizajnin dhe vendosjen e panove reklamuese e përcakton MTPT-ja.

MTPT-ja, përmes një tenderi publik sipas ligjit për prokurimin publik në fuqi, do të përzgjedh kompanitë për shfrytëzimin e hapësirës në brezin rrugor si dhe vendosjen e panove reklamuese sipas kushteve të këtij udhëzimi.

Të ardhurat financiare për shfrytëzimin e hapësirës në brezin rrugor të rrugëve regjionale dhe magjistrale dedikohen dhe konsiderohen të ardhura, për buxhetin e republikës së Kosovës.

Korniza e panove reklamuese duhet të jetë nga materiali i tillë që në momentin e goditjes me automjet konstruksioni i reklamës të deformohet.

Panot reklamuese duhet të kenë një shtyllë mbajtëse.

Neni 7

Bazamenti prej betonit i panove reklamuese duhet të jetë i nivelizuar me sipërfaqen e tokës dhe nuk lejohet të përdoret në forma të cilat sjellin rrezik për pjesëmarrësit në komunikacion në momentin e kontaktit me te.

Neni 8

Personat juridikë apo fizikë të interesuar për vendosjen e panove reklamuese duhet të bëjnë kërkesë dhe t'i rregullojnë raportet e tyre me kompanitë të cilat janë përzgjedhur nga MTPT-ja, për shfrytëzimin e hapësirës në brezin rrugor për vendosjen e panove reklamuese.

Personi fizike apo juridik kërkesës për marrjen e pëlqimit për vendosjen e reklamave dhe panove duhet t'i bashkangjesë:

Dorëzimi i projektit;

Numrin e reklamave që planifikon t'i vendosë dhe drejtimet në cilat rrugë duhet të vendosen.

Neni 9

Inspektorati në bashkërendim me Departamentin e Infrastrukturës Rrugore dhe Drejtorinë e Rrugëve jo më larg se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ, do të ndërmarrin veprimet me qëllim të konstatimit të gjendjes aktuale lidhur me panot reklamuese që janë të vendosura në rrugët regjionale dhe magjistrale.

Të gjitha panot reklamuese të cilat janë të vendosura në rrugët regjionale dhe magjistrale nga organet jo kompetente apo që nuk kanë pëlqim nga MTPT-ja, duhet të mënjanohen/largohen.

Për heqjen e reklamave dhe panove personat me kompetencë përkatëse do t'i njoftojnë palët me qëllim që t'i ndërmarrin veprimet për mënjanimin e tyre dhe të njëjtit do të njoftohen se mund të aplikojnë përsëri sipas kushteve të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 10

Përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ është Inspektorati i Ministrisë dhe departamentet kompetente.

Ministri sipas kompetencës së tij mundet të ndryshojë, plotësojë apo zëvendësojë këtë Udhëzim Administrativ për interesin publik.

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet çdo dispozitë mbi panot reklamuese e cila është në kundërshtim me të.

Neni 11

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri.

Prishtinë, datë 29.05.2008

Fatmir Limaj, Ministër